



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES**

**Tiranë, Mars 2018**

**Prof.Dr. Agron CUKA**



**REKTOR**

**RREGULLORE**

**“Për zhvillimin e Konkursit të Pranimit**

**Universiteti i Sporteve Tiranë**

**Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes”**

**Viti Akademik 2018 – 2019**

**DEKAN**

**Prof.Dr. Bardhyl MISJA**



**VITI AKADEMIK, 2018 – 2019**

**RREGULLORE E BRENDESHME MBI PROCEDURËN E ZHVILLIMIT TË  
KONKURSIONIT TË PRANIMIT TË STUDENTËVE  
PËR VITIN AKADEMIK 2018 – 2019**

Për të realizuar në praktikë zhvillimin sa më normal të konkursit praktik në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes si dhe për të mbështetur e lehtësuar mundësinë e vlerësimit sa më objektiv e transparent për seicilin kandidat kërkojmë të zbatohen me rigorozitet më të madh kërkesat e rregullores së mëposhtme:

**I. E drejta për konkurim**

Të drejtën për konkurimin praktik në Universitetin e Sporteve të Tiranës për vitin akademik 2018 – 2019 e fitojnë:

1. Kandidatët që kanë plotësuar formularin A2 pranë sekretarive të shkollave të mesme sipas Udhëzimeve të MASR.
2. Kandidatët që kanë bërë regjistrimin përfundimtar në Sekretarinë e UST pas përfundimit të provimeve të maturës kundrejt pagesës së tarifës së konkurimit.
3. Kandidatët që kanë plotësuar Kartelën Shëndetsore të UST.

**II. Ngritja e Komisioneve të Konkursit**

Rektori i UST merr masa dhe organizon që në strukturat e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes të ngrihet Komisioni i Konkursit të Pranimi i përbërë nga 3 – 5 anëtarë, për organizimin dhe mbarëvajtjen e konkursit:

1. Komisioni Qëndror (3 veta), është përgjegjës për të gjithë ecurinë e konkursit.
2. Komisioni i Verifikimit (3 veta), është përgjegjës për procedurat e verifikimit të kandidatëve konkurues.
3. Komisioni i nxjerrjes së Rezultateve Përfundimtare të Kandidatëve (3 veta), është përgjegjës për shpalljen e rezultateve përfundimtare të konkursit sipas kriterëve të përcaktuara. Rektori është Kryetar i këtij Komisioni, në të cilën përfshihen dhe dy drejtuesit e fakulteteve që organizojnë konkursin. Ky vendim do të merret dhe do të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit Qëndror.
4. Komisioni i ankimit (3 veta) nga të cilët kryetari duhet të jetë jurist, shqyrton të gjitha ankimet dhe mosmarveshjet gjatë zhvillimit të konkursit dhe shprehet me vendimin përkatës në përputhje me Rregulloren e Konkursit të pranimi në UST.

### **III. Procedurat e konkurimit**

1. UST shpall listën emërore të konkuresve për FSHL sipas rendit alfabetik jo më vonë se një javë përpara datës së konkurimit për Vitin Akademik 2018 – 2019.
2. Konkurimi Praktik fillon në orën 9.<sup>00</sup>. Paraqitja e konkurentëve bëhet në orën 8.<sup>00</sup>. Kjo orë së bashku me datën e konkurimit shpallet jo më vonë se një javë përpara datës së konkurimit.
3. Lejohet të hyjnë në mbientet ku zhvillohet konkursi vetëm kandidatët e listës së shpallur për konkurim të cilët duhet të jenë të pajisur me dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë biometrike). Kandidatët që nuk kanë asnjë nga këto dokumenta identifikimi nuk do të lejohen të marrin pjesë në konkurs.
4. Përpara konkurimit kandidatëve u komunikohen rregullat e konkursit të pranimit.
5. Testet praktike për konkursin e pranimit hartohen nga Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes dhe miratohen nga Senati i UST-së.
6. Testet e konkursit praktik u vihen në dispozicion konkuresve të paktën 3 muaj përpara datës së konkursit.
7. Në momentin e regjistrimit, konkuresit i jepet kartela personale e konkurimit në të cilën konkuresit i shënohen rezultatet e arritura në 2 Testet Praktike (Koha në sekonda dhe Distanca në metra).
8. Rradha e disiplinave konkurse do të jetë:
  - a. Testi - kërcim së gjati nga vendi 2 prova (shënohet rezultati më i mirë).
  - b. Testi - cirkuit, kryhet vetëm një provë pa të drejtë përsëritjeje.
9. Sejcili Komision Vlerësimi përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) vetë të brendshëm por mund të ketë në përbërje edhe të jashtëm. Do të ketë 1 (një) anëtar që komunikon me zë rezultatin dhe 1 (një) anëtar që shënon rezultatin e çdo konkuresi në kartelën e tij personale. Shënimi i rezultatit bëhet me stilolaps ngjyrë blu. Rezultati shënohet pa korigjim në fletën zyrtare të konkurimit, pas komunikimit me zë të lartë të këtij rezultati dhe një anëtar tjetër pranë tij hedh këtë rezultat në kartelën personale të konkuresit duke firmosur ai vetë dhe konkuresi në këtë kartelë.
10. Në rast të mos përputhjes së nivelit të rezultatit të shënuar në fletën zyrtare dhe në kartelën personale të konkuresit, personi përgjegjës do të mbajë përgjegjësi të plotë ligjore.
11. Kandidati ka të drejtë që të kryejë 2 prova në testin praktik Nr. 1 (kërcim së gjati nga vendi) dhe 1 provë në testin Nr. 2. (cirkuiti).

12. Përveç anëtarëve të komisioneve dhe përfaqësuesve të komisionit qendror ose personave të autorizuar prej tij asnjë i huaj, për asnjë arsye nuk mund të pranohet komisioneve të vlerësimit.
13. Për zhvillimin normal e të qetë të konkursit lajmërohet Komisariati i Policisë për angazhimin e policisë në tërë objektet ku zhvillohet konkurimi praktik.
14. Komisioni i Konkurimit Praktik, ka për detyrë që rezultatet përfundimtare të hedhura në fletën zyrtare do të memorizojnë dhe në formë elektronike. Komisioni, rezultatet përfundimtare me formularët origjinalë dhe në formë elektronike i përcjellë pranë Rektoratit në mënyrë që të ndiqen procedurat e përcaktuara deri në përcjelljen përfundimtare të rezultateve në Qendrën Kombëtare të Vlerësimit pranë MASR.
15. Lista përfundimtare e fituesve të konkursit do të shpallet nga Qendra Kombëtare e Vlerësimeve, pranë MASR.
16. Mbështetur në Vendimin Nr.9, datë 27.02.2018 pika 2, të Senatit të UST-së : “Kandidati konkurues, duhet të marrë së paku 10 pikë në testimin e konkursit praktik. Nëse merr më pak se 10 pikë, kandidati nuk shpallet fitues dhe nuk rregjistrohet për të ndjekur studimet”
17. Pas përfundimit të konkursit praktik, do të shpallen pikët e fituara nga çdo konkurues i cili do të mund të kontrollojë dhe të krahasojë me pikët e fituara sipas kartelës së tij personale vetëm nëpërmjet numrit të ID.
18. Rezultatet përfundimtare do të shpallen jo më vonë se 24 orë pas përfundimit të plotë të konkurimit.
19. Sejcili konkurent ka të drejtën e ankimit me shkrim të rezultatit pranë komisionit përkatës të ngritur qëllimisht për shqyrtimin e tërë ankesave duke e dorëzuar atë pranë Sekretarisë së Universitetit të Sporteve.
20. E drejta e ankimit ka afat derinë 48 orë nga shpallja e rezultateve përfundimtare, kjo edhe nëse brenda kësaj periudhe 2 ditore qëllojnë ditë e shtunë ose e djelë.
21. Pas 48 orëve nga shpallja e rezultatit, brenda ditës Komisioni i Ankimit dhe i rivlerësimit paraqet proces-verbalin përkatës me vendimin e formës së prerë në komisionin e pranimeve.
22. Pas kësaj periudhe, Komisioni Qendror i konkursit shpall listën përfundimtare të rezultateve të konkursit.

Në rast se gjatë konkurimit kërkohet ndonjë zgjidhje e paparashikuar në këtë Rregullore apo për ndonjë arsye tjetër të cfarë do lloji qoftë ajo, komisioni ka të drejtën e vendimmarrjes.

Kjo vendimmarrje do të pasqyrohet në një proces-verbal të veçantë në momentin e vendimit duke shpjeguar argumentet përkatëse.

**Normat e pranimit do të jenë të afishuara në ambjentet e hapura publike si dhe në faqen zyrtare të UST.**